

RAPORT MONITORIMI

MBI MBËSHTETJEN E SEKTORIT TË
RINISË 2019-2022
BASHKITË KUÇOVE DHE SKRAPAR



DHJETOR 2022

© 2022

SHOQATA NEW BRIDGES

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Raport Monitorimi mbi mbështetjen e sektorit të rinisë 2019-2022 Bashkia Kuçovë dhe Bashkia Skrapar

Email: uratereja@gmail.com;

Hartuar në nëntor-dhjetor 2022

© 2022 Shoqata “NEW BRIDGES” mbështetur nga Lëviz Albania.

Shoqata “NEW BRIDGES” është një organizatë jo fitimprurëse që synon “të kontribuojë në fuqizimin e komunitetit për pjesëmarrje, në jetën ekonomike –sociale në nivel vendor, nëpërmjet ndërgjegjësimit, programeve edukuese dhe iniciativave advokuese. Në këtë mënyrë New Bridges ndikon në zhvillimin ekonomik dhe social në nivel lokal.”

Hartoi: Dikensa Gjokutaj

Lista e shkurtimeve

AKR	Agjencia Kombëtare e Rinisë
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
IPARD	Instrument for Pre-accession Assistance for Rural Development
KVR	Këshilli Vendor Rinor
RMB	Raporti i Monitorimit të Buxhetit
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
PBA 23-25	Plani Buxhetor Afatmesëm 2023-2025
PBA 22-24	Plani Buxhetor Afatmesëm 2022-2024

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje	5
Mbështetja e sektorit të rinisë 2019-2022 në Bashkinë e Kuçovës	7
Mbështetja e sektorit të rinisë 2019-2022 në Bashkinë e Skraparit	14
Analizë: perceptimi i të rinjve mbi mbështetjen e sektorit të rinisë në dy bashkitë	18
Gjetje dhe konstatime mbi mbështetjen e sektorit të rinisë në Bashkinë Kuçovë dhe Bashkinë Skrapar: qasje krahasuese	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	25
Bibliografia	27

Përmbledhje

Ky raport hartohet në kuadër të projektit ‘*Aktivizmi rinor dhe dëgjimi i zërit të të rinjve në vendim-marrjen lokale në Bashkitë Skrapar dhe Kuçovë*’, financuar nga Lëviz Albania. Në këtë dokument synohet të jepet një panoramë e mbështetjes së sektorit të rinisë në Bashkinë Kuçovë dhe Bashkinë Skrapar për periudhën 2019-2022. Synohet të identifikohen masa të ndërmarra ku përfshihen financimi i aktiviteteve për rininë,¹ ofrimin e shërbimeve për të rinjtë si dhe krijimi dhe zhvillimi i infrastrukturës rinore. Gjetjet dhe rekomandimet mbështesin të rinjtë në advokimin e tyre për rritjen e mbështetjes së NJVV-ve në zbatimin e politikave rinore por dhe vetë NJVV-të në planifikim më të mirë të politikave dhe buxhetit në mbështetje të sektorit të rinisë.

Për hartimin e raportit janë hulumtuar burime parësore dhe dytësore. Si burim parësor konsiderohen përgjigjet zyrtare të përcjella nga Bashkitë në vijim të kërkesave për informacion të adresuara nëpërmjet koordinatorëve për të drejtën për informacion si dhe analiza e pyetësorit adresuar të rinjve në dy bashkitë respektive. Për sa i përket burimeve dytësore, është konsultuar dokumentacion zyrtar i publikuar në faqe elektronike zyrtare.

Raporti është i organizuar në pesë sesione përmbajtësore si dhe shtojcat pjesë përbërëse. Në sesionin e parë jepet një panoramë e mbështetjes së sektorit të rinisë 2019-2022 në Bashkinë e Kuçovës duke iu referuar më së shumti raporteve të monitorimit të buxhetit (RMB-të) duke synuar identifikimin e aktiviteteve dhe masave të mbështetura financiarisht. Më konkretisht janë marrë në analizë Programi buxhetor ‘*Sport dhe Argëtim*’ (08130) dhe Programi buxhetor ‘*Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore*’ (08220) të cilat hipotetizohet mund të përfshijnë zëra buxhetorë të dedikuar në realizimin e politikave/projekteve/programeve/infrastrukturës rinore.²

Në sesionin e dytë, në të njëjtën metodologji si në sesionin e parë, jepet një panoramë e mbështetjes së sektorit të rinisë 2019-2022 në Bashkinë e Skraparit.

Në sesionin e tretë paraqitet analizë e pyetësorit i cili synon të masë perceptimin e të rinjve mbi mbështetjen e sektorit të rinisë në dy bashkitë. Të anketuarit janë shprehur në pyetësorin anonim lidhur me mundësitë që ekzistojnë për zhvillimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete rinore, ekzistencën dhe funksionimin e infrastrukturës rinore apo cilësinë dhe sasinë e shërbimeve që ofrohen për ta në bashkitë respektive. Pyetësori është plotësuar nga 191 të anketuar, 109 anketues në Bashkinë Kuçovë (57.1%) dhe 81 anketues (42.4%) në Bashkinë Skrapar. Mbi 90% e të anketuarve i përkasin grupmoshës 15-30 vjeç. Rekomandimet konkrete janë përfshirë në aneksin 2 pjesë përbërëse e këtij raporti.

Në sesionin e katërt paraqiten gjetjet kryesore mbi mbështetjen e sektorit të rinisë parë në një qasje krahasuese midis Bashkisë Kuçovë dhe Bashkisë Skrapar.

Në sesionin e pestë paraqiten rekomandimet për përmirësimin e mbështetjes së sektorit të rinisë dhe qasjes buxhetore në të dy bashkitë për këtë sektor.

¹ “Të rinj” janë personat, i ri ose e re, që kanë mbushur moshën 15 vjeç deri në 29 vjeç, sipas Ligjit nr. 75/2019 “Për rininë” neni 3/f

² “Infrastrukturë rinore” është një hapësirë fizike, tokë, ndërtesë apo pjesë ndërtese e projektuar dhe e planifikuar veçanërisht për të rinjtë dhe veprimtaritë rinore, sipas Ligjit nr. 75/2019 “Për rininë” neni 3/ç).

Në raport janë përfshirë si **Aneks1** Pyetësi i hartuar për të dyja bashkitë dhe **Aneks 2** rekomandimet e dhëna nga anketuesit të agreguara për secilën bashki.

Kufizime të hasura gjatë procesit të hartimit të raportit:

- Dokumentat zyrtarë bazë për identifikimin e mbështetjes buxhetore të sektorit të rinisë janë raportet e monitorimit të buxhetit si dhe planet e buxhetit afatmesëm. Metodologjia e hartimit të këtyre raporteve nuk është e unifikuar në të dyja bashkitë. Si rrjedhojë, raportet nuk paraqesin informacion në të njëjtën formë dhe nivel analize buxhetore mbi realizimin e masave dhe ndërhyrjeve të bëra, indikatorët e performancës apo përshkrimit të aktiviteteve kryesore të ndërmarra, e të tjera. Gjithsesi, për hartimin e raportit është punuar bazuar në një sërë variablash kyç.
- Në faqen zyrtare të Bashkisë Kuçovë janë të publikuara vetëm RMB-të 2020, 2021 dhe 2022 si dhe PBA 2022-2024. Për këtë arsye nuk mund të raportohet specifikisht për vitin 2019. Por, për të dhënë panoramë sa më të gjerë, është përfshirë dhe viti 2022 në analizë. Në Bashkinë e Kuçovës raporti i fundit i publikuar në përputhje me kalendarin e hartimit të RMB-ve i përket periudhës janar-gusht 2022.
- Ndërkaq, Bashkia Skrapar nuk ka publikuar ende (deri në datë 27 dhjetor 2022) RMB-në janar-gusht 2022 dhe si rrjedhojë raportimi është fokusuar kryesisht në periudhën 2019-2021. Dokument tjetër kyç për analizën është dhe PBA 2023-2025 e cila nuk është publikuar nga Bashkia Skrapar. Për sa i përket analizës narrative të raporteve të monitorimit konstatohet se RMB 2019 nuk është e shoqëruar me analizë narrative ashtu si raportet e tjera. Në këtë mënyrë mungon interpretimi i të dhënave dhe pasqyrim i indikatorëve, produkteve dhe aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të programeve buxhetore.
- Për të patur informacion sa më të plotë në mbështetje të analizës, janë përcjellë dy kërkesa për informacion për bashkitë të cilat u kanë dhënë përgjigje zyrtare vetëm kërkesës së parë dhe me informacion të kufizuar. Deri në datë 27 dhjetor 2022 nuk ka patur përgjigje nga asnjëra bashki ndaj kërkesës së dytë për informacion shtesë/sqarues të adresuar në datë 5 dhjetor 2022.
- Programet buxhetore nuk janë të shoqëruara me pasqyra të detajuara për aktivitetet që mbulohen në këto programe dhe buxhetet e alokuara, për të analizuar si rrjedhojë më qartësisht buxhetin që alokohet në mbështetje të sektorit të rinisë/të rinjtë.

MBËSHTETJA E SEKTORIT TË RINISË 2019-2022 NË BASHKINË E KUÇOVËS

Sipas Censurit të vitit 2011 Bashkia e Kuçovës numëron 31.262 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 55.293 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 160.23 km² dhe bazuar në ndarjen e re administrativo-territoriale, qyteti i Kuçovës si kryeqendra e bashkisë, bashkohet me tre komuna.³

Misioni i Bashkisë së Kuçovës e mbi të cilën bazohet planifikimi buxhetor, përtej qëllimit ekonomik, është *‘të krijojë një mjedis shoqëror të shëndetshëm nga i cili përfiton i gjithë komuniteti, ku e mira e përbashkët mbizotëron; ku banorët jetojnë në harmoni me burimet natyrore, hapësirat publike dhe komunitetet e tjera që e rrethojnë, sot e në vazhdim.*⁴

Ky mision mbështetet në 4 objektiva afatgjata të Bashkisë Kuçovë të identifikuar në dokumentat e planifikimit buxhetor.

Objektivi strategjik 1: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik-social, duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të Bashkisë Kuçovë në sektorin industrial, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.

Objektivi strategjik 2: Zhvillim i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të mobilitetit, transportit dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.

Objektivi strategjik 3: Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor, në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementët e fortë natyrorë dhe artificialë në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integritetit me potencialet rajonale turistike.

Objektivi strategjik 4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor.⁵

Në objektivat strategjikë të Bashkisë të reflektuara në RMB-të dhe PBA nuk adresohet grupmosha e të rinjve specifikisht. Nga konsultimi i raporteve të monitorimit të buxhetit të vitit 2020, 2021 dhe janar-gusht 2022 si dhe Planit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 (PBA 23-25) nuk identifikohet program buxhetor i apo dhe zë buxhetor i dedikuar për projekte/programe/nisma rinore. Për këtë çështje është kërkuar informacion edhe në Bashkinë Skrapar i cili në përgjigje adreson në konsultimin e dokumentave buxhetorë të publikuar.

Gjithsesi, edhe pse nuk ka një program apo zë buxhetor të dedikuar projekteve/programeve rinore, kjo grupmoshë, si pjesë e popullsisë së përgjithshme të komunitetit, përfiton nga masa/aktivitete/financime të mbështetura në programe të ndryshme buxhetore siç janë:

- Programi *‘Sport dhe Argëtim’* (08130)
- Programi *‘Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore’* (08220).

³ Qarku Berat, faqja zyrtare, parë për herë të fundit në datë 6.12.2022, <https://qarkuberat.gov.al/bashkia-Kucove/>

⁴ Bashkia Kuçovë, RMB 2021, faqe 2-3.

⁵ Ibidem

- Programi 'Arsimi i mesëm i përgjithshëm' (09230) ku mbështeten dhe investimet më të mëdha kapitale në infrastrukturën shkollore.
- Programi 'Kujdesi social për familjet dhe fëmijet' (10430) për kategoritë vulnerabël.

Për të vlerësuar nëse janë marrë masa konkrete për zbatimin e nenit 7, pika 1/ë e Ligjit për Rininë i cili kërkon parashikimin në buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore të fondeve *për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore*, si dhe neni 7, pika 1/dh, ku kërkohet *financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta*, janë marrë në shqyrtim programet 'Sport dhe Argëtim' dhe 'Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore'. Analiza për sa më sipër është mbështetur në hulumtimin e:

- Raporteve të monitorimit të Buxhetit për vitin 2020; 2021; 2022 (janar-gusht) të dy programeve buxhetore: 'Sport dhe Argëtim' dhe 'Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore';
- Projekt-buxhetin afatmesëm 2022-2024;
- Përgjigja zyrtare e ardhur nga Bashkia Kuçovë.

Konstatohet se në faqen zyrtare të Bashkisë Kuçovë janë të publikuara vetëm RMB-të 2020, 2021 dhe 2022 si dhe PBA 2022-2024. Për këtë arsye nuk mund të raportohet specifikisht për vitin 2019. Por, për të dhënë panoramë sa më të gjerë, është përfshirë dhe viti 2022 në analizë. Në Bashkinë e Kuçovës raporti i fundit i publikuar në përputhje me kalendarin e hartimit të RMB-ve i përket periudhës janar-gusht 2022.

Programi 'Sport dhe Argëtim'

Spektori i sportit bazohet në objektivat e mëposhtme:

- Mirëmbajtja e ambienteve të stadiumit dhe aneksit nga punonjësit e sportit.
- Ndjekja e ekipit të Sportit Volejbolli për femrat para të reja.
- Ndjekja e ekipit të Sportit të Futbollit, ndeshjet e realizuara në Klubin e Sportit SHA Naftëtari.⁶
- Ndjekja e stërvitjeve për ekipin e Bilardos.⁷

Në të tre RMB-të (2020-2021-2022) e shqyrtuara është raportuar si masë kryesore e ndërmarrë për sektorin e sportit për periudhën raportuese vetëm *'dizifektimi dhe mirëmbajtja e stadiumit'* duke konfirmuar mungesën e mbështetjes së aktiviteteve buxhetore që targetojnë të rinjtë, projekteve sportive apo argëtuese rinore. Gjithashtu mungon analiza e qartë mbi aktivitetet buxhetore të mbështetura për këtë program buxhetor.

Shpenzimet plan ose fakt për këtë program për vitet 2019-2024:

Buxhet total; Bashkia Kuçovë Buxheti i Programit 'Sport dhe Argëtim' 08130						
Viti 2022	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
521, 084, 717 (Plan, RMB 2022/ PBA 22-24)	11,378, 350 (fakt RMB 2020)	10,190,832 (fakt RMB 2021)	12,525,940 (plan PBA/ RMB 2021)	12, 776, 440 (plan fillestar RMB 2022)	Nuk identifikohet informacion per programin 08130 në PBA 22-24	

⁶ Ibidem, faqe 26.

⁷ Bashkia Kuçovë, RMB 2020, faqe 45.

Programi 'Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore'

Programi buxhetor që mbulon trashëgiminë kulturore, eventeve artistike dhe kulturore përfshin tre sektorë: Qendrën Kulturore, Bibliotekën Publike dhe Qendrën Rinore. *'Qëllim i këtij programi është të ofrojë për komunitetin aktivitetet kulturore me cilësi të lartë, shërbim korrekt dhe të shumëllojshëm ndaj anëtarëve të bibliotekës, mbështetje për të rinjtë në realizimin e ideve që ata kanë'.*⁸ Objektivat që synohen të realizohen janë:

- Ofrimi i projekteve artistike e kulturore inovative me një cilësi të lartë e bashkëkohore.
- Përmirësimin e jetës sociale të qytetarëve nëpërmjet ndërthurjes së projekteve tradicionale me angazhimin qytetar në këto projekte.
- Prezantimi e promovimi i vlerave të qytetit për vizitorin e huaj.
- Shtimi i fondit të librave për të gjitha grup moshat.
- Rritja e numrit të lexuesve dhe shumëllojshmërisë së librave të lexuara prej tyre.
- Promovimi i veprave dhe autorëve të ndryshëm e kryesisht atyre vendas.
- Bashkëpunimi me shkollat e mesme në funksion të gjallërimit të jetës në funksion të zhvillimit të aktiviteteve rinore për librin, poezinë, e të tjera.⁹

Në këtë program buxhetor grupmosha e të rinjve përfshihen në qëllimin e tij (*mbështetje për të rinjtë në realizimin e ideve që ata kanë*) si dhe në objektivat që synohen të realizohen (*...funksion të zhvillimit të aktiviteteve rinore per librin, poezinë, e të tjera*). Nga ky program buxhetor financohet qendra rinore e cila konsiderohet "Infrastrukturë rinore" sipas përkufizimit ligjor 'hapësirë fizike, ndërtesë e projektuar dhe e planifikuar veçanërisht për të rinjtë dhe veprimtaritë rinore'. Kjo Qendër është pjesë e Qendrës Kulturore dhe frekuentohet nga të rinj të grupmoshes 14 - 22 vjeç duke zhvilluar aktivitetin e saj mbi moton: *'Të rinjtë për të rinjtë!'*.

Qendra drejtohet nga një Bord Drejtues i cili, siç raportohet, realizon mbledhje periodike të përmuajshme ku diskutohet mbi aktivitetet e muajit, planifikimin për muajin në vijim dhe angazhime të tjera. Aty ofrohen aktivitete ditore si dhe organizime siç janë klubet e dedikuara: klubi i kërcimit, klubi i pianos, klubi i anglishtes, klubi i Ping Pong-ut apo "Cooking Classes" i cili është një aktivitetet mujor që zhvillohet në ambientet e kuzhinës së Qendrës.

Gjatë vitit 2020, nisur nga situata e krijuar për shkak të Covid - 19 dhe shpalljes së Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore, shumë aktivitete të planifikuara janë anuluar në këto institucione. Gjithsesi brenda hapësirave ka patur disa aktivitete në mbështetje të të rinjve të cilat janë realizuar përgjatë 3 viteve të analizuara.

Në PBA 2022-2024 për këtë program buxhetor është parashikuar një produkt i cili targeton direkt të rinjtë: *'Trajnime të të rinjve'*.¹⁰ Megjithatë, në mungesë të një analize të qartë mbi aktivitetet buxhetore që përfshihen në këtë program buxhetor nuk kuptohet buxheti faktik i alokuar për 'trajnime për të rinjtë' apo projekte rinore. Realizimi i shpenzimeve raportohet sipas variablës së 'artikullit' dhe jo në nivel aktiviteti duke e detajuar shpenzimin sipas artikujve për të qenë më i qartë për lexuesin.

⁸ Bashkia Kuçovë, PBA 2022-2024, faqe 37.

⁹ Bashkia Kuçovë, RMB 2020, 2021, 2022

¹⁰ Bashkia Kuçovë, PBA 2022-2024, faqe 39.

Bashkisë Kuçovë i është kërkuar informacion lidhur me zërat buxhetore specifike të planifikuara për zhvillimin e programeve, projekteve dhe veprimtarive rinore si dhe mbi financimin e veprimtarisë së Qendrës Rinore. Bashkia Kuçovë adreson në konsultimin e dokumentave buxhetorë të publikuara pa dhënë përgjigje specifike.

Më poshtë gjendet një tabelë përmbledhëse e aktiviteteve të paraqitura në analizën narrative të raporteve të monitorimit të buxhetit për periudhën 2020-2022. Gjithsesi, për arsyet e mësipërme, është e paqartë cilat prej këtyre aktiviteteve janë financuar nga buxheti i Bashkisë.

Kategori	RMB 2020
Bashkëpunimi me partnerë	Janë zhvilluar disa trajnime me qëllim ngritje kapacitetesh të rinjve: • Komunikimi dhe ndërtimi i vetëbesimit; • Vetëdisipina, menaxhimi vendimmarrja dhe lidhshipia; • Rruga drejt integritetit dhe zhvillimit të rinisë; • Bashkëveprimi, trajtimi i konfliktit dhe gjithëpërfshirja; • Shkrimi i Cv-së dhe intervista në punë; • Trajnimet online dhe vështirësitë që hasen për marketingun/ strategjinë Erasmus + • Vullnetarizmi në Ballkan; • Menaxhimi i Alternuar i Mbetjeve në Rrang Qarku; • Roli i shoqërisë civile në transparencën e industrisë nxjerrëse në Shqipëri; • Realizimi i Karnavaleve , " Interpretimi për stop Covid- 19"; • Pjesëmarrje e të rinjve në konkursin: "Promovo Qytetin tënd"; • Takim me Delegatë të OKB me temë: "Sa të afte janë të rinjtë e Kuçoves për tu përfshirë në zhvillimin e komunitetit të tyre"; • Raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën janar-dhjetor 2020; • Takime për hartimin e Planeve të Veprimtari për Rininë për Ligjin e Rinisë; • Zgjedhja e një të riu nga qyteti si anëtar i Kongresit Rinor Kombëtar
Trajnime	• Menaxhimi i stresit; • Adoleshenca; • Kultura vendase; • Shëndeti mendor gjatë COVID 2019; • Si të bëhemi sipërmarrës të suksesshëm; • Teknologjia në ndihmë të nxënësve dhe studentëve; • Njohja me 'Yes program'; • Arsiki, brenda apo jashtë vendit; • Holokausti; • Trafikimi i qenieve njerëzore, rreziku në drejtime të ndryshme; • "Stop dhunës në familje"; • Vullnetarizmi.

Kategori	RMB 2020
Diskutime / Debate	• Takohemi për një libër; • Muzika dhe të rinjtë; • Sfidat e mësimi Online; • Lidership (aktivitet 1 javor) me mbështetjen e programit ‘Bashkitë për në Europë’; • Qëllimet dhe planet e së ardhmes; • Aktivizmi rinor dhe roli i senateve; • Informacionet (e rreme, të vërteta në median sociale).
Musa Club	• Pa limit (lojëra, kuitz); • Te zhvillojmë inteligjencën me anë të lojërave dhe ushtrimeve; • Respektojmë rregullat e distancës dhe lojës; • Argëtimi i të rinjve dhe nxitja e bashkëpunimit; • Të rinjtë dhe aktivitetet sportive; • Të rinjtë dhe roli i tyre.
Aktivitete në komunitet	• Dita e Verës; • Takime informuese për mjedisin, në rang Qarku; • Menaxhimi i integruar i mbetjeve në rang Qarku; • Të argëtohem me emojn e preferuar; • Green Berat; • Takim informues për mjedisin, nga projekti në rang Qarku; • Menaxhimi i integruar i mbetjeve në rang Qarku. • Takime online • Barazia gjinore; • Ngritja e bizneseve online; • Ngritja e kapaciteteve të stafit për shkrimin e një projekti; • Fuqizimi për ngritje të Këshillave Rinorë; • Kurse për aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve.

Kategori	RMB 2021
Bashkëpunimi me partnerë	• Kongresi Rinor "Ligji i Rinisë". • Neë Bridges (Për një mjedis sa më të pastër). • Gruaja Naftëtare. Nxitja e të rinjve votues për herë të parë; • Përtej Barrierave, krijimi i mundësive tek të rinjtë për punësim dhe verëpunësim. • KRIK, vet disiplina, menaxhimi, vendimmarrja dhe lidhshipi; • Përfshirja e të rinjve të Qendrës në bashkëpunim me organizatat rinore të SHC; • Takime për hartimin e Planeve të Veprimit për Rininë per Ligjin e Rinisë; • Raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2021; • Top Channel në partneritet me Friedrich Ebert Stiftung EV; • Bashkimi Evropian "Fuqizimi i Gazetarisë në funksion të Llogaridhënies dhe Demokracisë
Trajnime	• Qëllimet dhe planet e së ardhmes; • Menaxhimi i stresit; • Rreziqet e internetit; • Shëndeti mendor gjatë Covid-19.
Takime online	• Diskutim mbi "Miratimin e Ligjit të Rinisë"; • Ngritja e kapaciteteve të 12 të rinjve për vullnetarizëm, si monitorues të të zgjedhjeve ; • Ngritja e bizneseve online; • Nxitja e të rinjve votues për herë të parë për të votuar si qytetar të këtij vendi; • Ndërgjegjësimi i të rinjeve për çështje mjedisore; • Media rinore.

Kategori	RMB janar-gusht 2022
Bashkëpunimi me partnerë	• Kryqin e Kuq dega Kuçovë kurs i gjuhës angleze për grupmoshat nga klasa 7 14vjeç. • Citizens Channel përmbylli ciklin e trajnimeve "Media Literacy - Fake vs Facts". Rreth 25 të reja dhe të rinj mësuan mbi edukimin mediatik, çështjet gjinore në media, aktivizmin përmes medias dhe përdorimin e telefonit për krijimin e materialeve multimediale përmes "'Mobile Journalism". Gjatë trajnimeve të rinjtë u aktivizuan në krijimin e përmbajtjes gazetareske në terren për të realizuar katër produkte multimediale. Ata raportuan për tematika si emigrimi në qytetin e Kuçovës, pusët jofunksionale të naftës, problemet e biznesit të vogël si pasojë e rritjes së cmimeve dhe përdorimin e celularit nga të rinjtë. • Dy projekte në bashkëpunim me organizatën New Bridges dhe TiranaYouth Center titulluar 'Të rinj të fuqizuar, zë aktiv në shkolle dhe komunitet'. • Projekti 'Aktivizimi rinor dhe degjimi i zërit të të rinjve në vendimmarrjen lokale' ka si qëllim ndërgjegjësimin lokal dhe vendimmarrjen për to, mbështetur nga Lëviz Albania

Buxheti plan/fakt për këtë program për vitet 2020-2024:

Buxhet total; Bashkia Kuçovë Buxheti i Programit 'Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore' 08220						
Viti 2022	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
521, 084, 717 (Plan, RMB 2022/ PBA 22-24)	15, 271, 514 (fakt RMB202)	6, 798, 139 (fakt RMB2021)	8, 539, 830 (plan PBA/RMB 2021)	8,755,440 (plan PBA/RMB 2022)	8, 855, 440 (Plan PBA 22-24)	8, 855, 440 (Plan PBA 22-24)

Zbatimi i detyrimeve në kuadër të ligjit për rininë

Ligji për Rininë parashikon KVR-në si organ këshillimor që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë. Në përgjigjet zyrtare nga dy Bashkitë konfirmohet ngritja e KVR-ve gjatë vitit 2022. Bashkia Kuçovë ka ngritur KVR-në me Vendim nr.10, datë 16.0.2022 (4 anëtarë) duke përbërë progres për sa i përket realizimit të detyrimeve të kuadrit ligjor për rininë. Gjithsesi, është për tu parë angazhimi përmbajtësor në rolin e tij si këshillues për NJVV-në, vlerësues dhe propozues për nisma në mbështetje të sektorit të rinisë.

Për sa i përket dokumentave strategjike për sektorin e rinisë mungon një i tillë. Në përgjigjen e dhënë nga Bashkia shprehet vullneti pozitiv për hartimin e një dokumenti të tillë. Gjithsesi Strategjia Kombëtare e Rinisë e miratuar këtë vit me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 26.10.2022, është dokument strategjik kombëtar i cili, në mungesë të një kuadri strategjik vendor, mund të jetë referencë për hartimin e politikave, programeve dhe projekteve rinore.

Bashkia Kuçovë ndërkohë siguron infrastrukturë rinore, konkretisht Qendra Rinore, pjesë e institucionit Qendra Kulturore "Feniks". Kjo qendër ka Bord Drejtues i cili përzgjidhet nga vetë të rinjtë të cilët frekuentojnë Qendrën. Bordi ka në strukturë presidentin, zv presidentin, sekretarin dhe anëtarët, gjithsej 11 persona.

Siç deklarohet nga vetë Bashkia, Qendra është mjaft aktive në zhvillimin e aktiviteteve rinore dhe përbehet kryesisht nga të rinj. Aktivitetet bazohen kryesisht tek: zhvillimi i politikave për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje, evidentimi dhe monitorimi i problemeve të komunitetit dhe të të rinjve, krijimi i hapësirave për nxitjen dhe zhvillimin e iniciativave inovative nga të rinjtë e qytetit dhe takime informuese për ngritjen e kapaciteteve të tyre. Analiza dhe raportimi i aktivitetit të Qendrës bëhet çdo katër muaj për Këshillin Bashkiak, por jo për institucione të tjera.

Si përmbledhje, për sa i përket detyrimeve sipas kuadrit ligjor për rininë Bashkia Kuçovë:

- **Ka** progres për sa i përket ngritjes zyrtarisht të KVR-së. Por, është për tu vlerësuar në vijim angazhimi kuptimplotë i kësaj strukture në mbështetje të sektorit të rinisë.
- **Përmbush detyrimin** e sigurimit të infrastrukturës rinore me funksionimin e Qendrës rinore si hapësirë e dedikuar për aktivitetet rinore.
- **Ka të ngritur** strukturën administrative e cila mbulon çështjet rinore dhe ka në vartësi raportimi Qendrën Rinore.
- **Nuk ka** dokument strategjik apo plan veprimi në të cilën të jenë ndër të tjera të përcaktuara objektivat vendore dhe prioritetet për respektimin e të drejtave të të rinjve, mbrojtjen dhe fuqizimin e të rinjve.
- **Nuk ka** në buxhetet saj fonde për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore.

MBËSHTETJA E SEKTORIT TË RINISË 2019-2022 NË BASHKINË E SKRAPARIT

Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia e Skraparit numëron 12,403 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 16,581 banorë.¹¹ Bashkia e re ka një sipërfaqe të konsiderueshme prej 831.44 km². Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Çorovodës.¹²

Për tu realizuar vizioni për Bashkinë Skrapar janë parashikuar katër objektiva strategjike në Planin Buxhetor Afatmesëm:

Objektivi Strategjik 1 adreson rigjenerimin ekonomik i zonës. *‘Zhvillimi i balancuar i mëtejshëm ekonomik i zonës mundet të arrihet përmes zhvillimit të sektorit të përpunimit të produkteve bujqësore dhe blektorale dhe promovimit të formave alternative të turizmit. Ky zhvillim ekonomik pritet të kontribuojë dhe në rigjenerimin e popullsisë përkatëse si dhe frenimin e flukseve migratore e cila do të ndikojë në rritjen e popullsisë.’*

Objektivi Strategjik 2 adreson menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit. *‘Mbrojtje dhe përdorim të drejtë të sistemeve të tokës dhe ato ujore, mbrojtjes së habitateve dhe ekosistemeve (Parku Kombëtar në Tomor, promovimit dhe zhvillimit të peisazheve natyrore dhe gjeomonumenteve, Kanionet Osumit dhe kanione të tjera,) në mënyrë që të arrihet ruajtja e mjedisit natyror të pastër i cili mund të jetë burim i rendësishëm për pritjen e formave të ndryshme alternative të turizmit.’*

Objektivi Strategjik 3 adreson zhvillimin e infrastrukturës teknike. *‘Ndërtimi dhe përfundimi i ndërtimit të infrastrukturës teknike për të përmirësuar aksesin e njerëzve dhe mallrave në qendrën e bashkisë por edhe në qendra më të vogla administrative në territorin e Bashkisë si dhe në resurset turistike, qendrat urbane rajonale dhe infrastrukturave strehim, argëtim, pritje, që do të cojnë në rimëkëmbien e zonës.’*

Objektivi Strategjik 4 adreson zhvillimin e komuniteteve të qëndrueshme. *‘Formimi i komuniteteve të qëndrueshme duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve dhe promovimit të identitetit të fortë të bashkisë në lidhje me produktet bujqësore dhe blektorale cilësore dhe burimeve natyrore.’¹³*

Nga konsultimi i raporteve të monitorimit të buxhetit të vitit 2019, 2020 dhe 2021 si dhe Planit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 (PBA 23-25) konstatohet mungesa e referimit në objektivat strategjike të sektorit të rinisë si dhe mungesa e programit buxhetor të dedikuar. Nga Bashkia Skrapar po ashtu konfirmohet se për periudhën buxhetore 2019-2022, nuk ka patur masa cilat janë në mbështetje të politikave, nismave për rininë por *‘mbetet një sfidë për të ardhmen’*. Në këtë përgjigje deklarohet se *‘në Buxhetin e vitit 2023 të Bashkisë Skrapar pritet të parashikohet një zë buxhetor i veçantë për veprimtaritë, projektet apo programet rinore.’* Gjithsesi ky pohim nuk mbështetet nga dokumenti i PBA 2023-2025 i publikuar në të cilën nuk identifikohet zë buxhetor specifik në mbështetje të politikave, nismave për rininë.

Gjithsesi, kjo grupmoshë përfiton nga masa/aktivitete të mbështetura në programe të ndryshme buxhetore siç janë:

- Programi *‘Sport dhe Argëtim’* (08130)
- Programi *‘Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore’* (08220)

¹¹ Bashkia Skrapar, PBA 2022-2024, faqe 10.

¹² Qarku Berat, faqja zyrtare, parë për herë të fundit në datë 6.12.2022, <https://qarkuberat.gov.al/bashkia-skrapar/>

¹³ Bashkia Skrapar, RMB 2021, faqe 10.

- Programi 'Arsimi i mesëm i përgjithshëm' (09230) ku mbështeten dhe investimet më të mëdha kapitale në infrastrukturën shkollore.
- Programi 'Përkujdesi social' (10430)

Për sa i përket analizës narrative të raporteve të monitorimit konstatohet se RMB 2019 nuk është e pajisur me analizën narrative. Si rrjedhojë, mungon interpretimi i të dhënave dhe pasqyrim i indikatorëve, produkteve dhe aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të programeve buxhetore për këtë vit.

Programi 'Sport dhe Argëtim'

Në raportet e monitorimit të buxhetit nuk shprehen objektivat e programeve buxhetore, si në rastin e RMB-ve të Bashkisë Kuçovë, por pasqyrohen përshkrimet e programeve si dhe indikatorët kyç. Sipas përshkrimit që i bëhet në raportet e monitorimit të buxhetit, në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për vënie në funksion ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive si dhe mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive. Po ashtu përfshihet edhe dhënia e granteve, huave apo financime për të mbështetur ekipet apo lojtarë individualë.¹⁴ Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet që bashkia të mbështesë organizimin e eventeve sportive dhe argëtuese.¹⁵

Ndërkohë, bazuar në raportin e vitit 2020 dhe 2021 dy janë indikatorët kyç të performancës. Të dy indikatorët nuk adresojnë specifikisht target grup të rinjve:

- Shtimi i sipërfaqes së hapësirave çlodhëse dhe argëtuese.
- Përmirësimi i strukturave dhe terreneve sportive për veprimtari sportive.¹⁶

Është për tu theksuar që në PBA 2022-2024 është shtuar një indikator: 'Numri i sportistëve të mbështetur' duke treguar qasje me të hapur ndaj mundësisë për të mbështetur dhe sportistë të rinj. Planifikohet të mbështeten 20 sportistë çdo vit për periudhën 2022-2023.¹⁷ Por, në mungesë të RMB 2022, nuk mund të identifikohet nëse ka patur ecuri në realizimin e këtij indikator për vitin 2022.

Shpenzimet plan ose fakt për këtë program për vitet 2019-2024:

Buxhet total; Bashkia Skrapar Buxheti i Programit 'Sport dhe Argëtim' (000 lek)						
Viti 2022	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
331,022 (plan PBA 22-24)	2,484 (fakt PBA 22-24)	4344 (fakt PBA 22-24)	5773 (plan i rishikuar PBA 22-24)	5424 (plan PBA 22-24)	5476 (plan PBA 23-25)	5,776 (plan PBA 23-25)

Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mirë administrimi e fuqizimi i institucioneve menaxhuese. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe promovimit të eventeve kulturore dhe artistike.

¹⁴ Bashkia Skrapar, RMB 2021 faqe 70.

¹⁵ Bashkia Skrapar, RMB 2020, faqe 45.

¹⁶ Bashkia Skrapar, RMB 2020, faqe 48

¹⁷ Bashkia Skrapar, PBA 2023-2025, <https://bashkiaskrapar.gov.al/pba.html>

Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për kulturën.¹⁸

Bazuar në raportin e vitit 2020 tre janë indikatorët kyç të performancës të realizuar për këtë program buxhetor:

- Shtimi i aktiviteteve kulturore të organizuara nga Bashkia.
- Përmirësimi i aseteve të trashëgimisë kulturore.
- Panairë të organizuara nga bashkia.¹⁹

Në të dhënat më të detajuara për programin për vitin 2020 kanë qenë përfshirë dhe shtatë *‘Aktivitete për edukimin e brezit të ri’* por pa mundur të realizohen. Po ashtu nuk janë realizuar as njëzet e tre shfaqje kulturore apo evente artistike si dhe dy panairët e planifikuara. Ndërkohë janë mirëmbajtur trembëdhjetë asetet e trashëgimisë kulturore siç ka qenë planifikuar.²⁰ Për mos realizimin e indikatorëve të mësipërm vlen të theksohet edhe konteksti i vitit 2020 dhe situata e pandemisë.

Në mungese të infrastrukturës rinore të dedikuar në RMB-të e shqyrtuara nuk ka analiza narrative mbi aktivitete rinore të zhvilluara si ato të realizuara në Qendrën Rinore Kuçovë. Bashkia përgjigjet ndaj kërkesës për informacion mbi politika/masa/aktivitete rinore të zhvilluara gjatë vitit 2020-2022 se : *‘Janë realizuar disa aktivitete në kuadër të mbështetjes për të rinjtë, sikurse ka qenë dhe vazhdon të jetë bashkëpunimi me “New Bridges”, apo “Leviz Albania” e cila së fundmi ka sponsorizuar një aktivitet shume dimensional për fëmijët dhe të rinjtë e qytetit.*²¹ Për saktësim të përgjigjes nga Bashkia, projekti është mbështetur nga Lëviz Albania dhe implementuar nga Organizata New Bridges.

Edhe pse nuk identifikohet qartësisht një zë buxhetor për rininë, konstatohet se është i përfshirë në këtë program buxhetor aktiviteti *‘aktivitete për edukimin e brezit të ri’*, i cili për vitin 2020 konsiderohet i përfshirë. Në PBA 2023-2025 targeti për realizimin e këtij aktiviteti ka tendencë ulëse. Nga gjashtë aktivitete në vitin 2021, në vitin 2022 plan është një, në vitin 2023 plan janë dy dhe në vitet 2024 dhe 2025 nga një aktivitet.²² Në PBA 2022-2024 target kanë qenë me ambiciozë ku për vitin 2022 planifikohejshin tetë aktivitete të tilla dhe në vitet 2023 dhe 2024 planifikohejshin nga dhjetë aktivitete.²³ Trendi ulës në target që adreson aktivitet për të rinjtë shënjon regres në vëmendjen për këtë sektor.

Shpenzimet plan ose fakt për këtë program për vitet 2019-2024:

Buxhet total; Bashkia Skrapar Buxheti i Programit ‘Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore’ (000 lek)						
Viti 2022	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
331,022 (plan PBA 22-24)	4367 (fakt PBA 22-24)	5085 (fakt PBA 22-24)	5605 (plan i rishikuar PBA 22-24)	6052 (plan PBA 22-24)	6252 (plan PBA 23-25)	6402 (plan PBA 23-25)

¹⁸ Bashkia Skrapar, RMB 2019 dhe RMB 2020.

¹⁹ Bashkia Skrapar, RMB 2020, faqe 52.

²⁰ Bashkia Skrapar, RMB 2020, faqe 51.

²¹ Bashkia Skrapar, Përgjigje kërkesës për informacion, datë 16 nëntor 2022.

²² Bashkia Skrapar, RMB 2021 faqe 70.

²³ Bashkia Skrapar, PBA 2022-2024, faqe 100.

Zbatimi i detyrimeve në kuadër të ligjit për rininë

Bashkia Skrapar e ka krijuar dhe miratuar Këshillin Vendor Rinor me VKB Nr.57, datë 29.09.2022 *‘Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Vendor Rinor’* konfirmuar nga Prefektura me nr. 755/1, datë 11.10.2022. Bazuar në VKB e sipërcituar ky Këshill kryesuar nga Kryetari i Bashkisë përbëhet nga gjashtë anëtarë me përbërjen si mëposhtë :

- Kryetari i Bashkisë;
- Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Social, Arsimit, Sportit, Kulturës dhe Rinisë;
- Përfaqësues të Qeverisë së Nxënësve;
- Përfaqësues të tjerë.²⁴

Aktualisht, as për këtë bashki, nuk ka një dokument strategjik për sektorin e rinisë. Gjithsesi, në përgjigjen e dhënë nga Bashkia shprehet vullneti pozitiv për hartimin e një dokumenti të tillë.

Bashkia Skrapar nuk ka qendër rinore dhe konkretisht hapësira që përdoren edhe në funksion të të rinjve konsiderohen terrenet sportive dhe Qendra Rekreative Multifunkionale e ndërtuar së fundmi që Bashkia financon për mirëmbajtjen e tyre. Projekti i kësaj qendre, i ngritur në bashkëpunim me IADSA, synon *‘transformim rrënjësor të një sipërfaqeje të konsiderueshme të mbushur me ndërtime pa leje apo të rrënuara dhe kthimin në një qendër rekreative për fëmijët, të rinjtë dhe moshën e tretë’*.²⁵

Si përmbledhje, për sa i përket detyrimeve sipas kuadrit ligjor për rininë Bashkia Skrapar:

- **Ka** progres për sa i përket ngritjes zyrtarisht të KVR-së. Por, është për tu vlerësuar në vijim angazhimi kuptimplotë i kësaj strukture në mbështetje të sektorit të rinisë.
- **Nuk përmbush detyrimin** e sigurimit të infrastrukturës rinore të dedikuar.
- **Ka të ngritur** strukturën administrative e cila mbulon *de juro* çështjet rinore, më konkretisht Drejtorinë e Shërbimit Social, Arsimit, Sportit, Kulturës **dhe Rinisë**.
- **Nuk ka** dokument strategjik apo plan veprimi në të cilën të jenë ndër të tjera të përcaktuar objektivat vendore dhe prioritetet për respektimin e të drejtave të të rinjve, mbrojtjen dhe fuqizimin e të rinjve.
- **Nuk ka** në buxhetet saj fonde për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore.

²⁴ Bashkia Skrapar, Vendim i Këshillit Bashkiak nr.57, datë 29.09.2022.

²⁵ Bashkia Skrapar, Qendra Rekreative, <https://bashkiaskrapar.gov.al/2021/06/06/qendra-rekreative/>

ANALIZË: PERCEPTIMI I TË RINJVE MBI MBËSHTETJEN E SEKTORIT TË RINISË NË DY BASHKITË


Me qëllim matjen e perceptimit të të rinjve mbi mbështetjen e sektorit të rinisë është hartuar një pyetësor anonim adresuar të rinjve të dy bashkive. Pyetësi përbëhet nga 10 pyetje të cilat adresojnë të dhëna demografike dhe sociale të të anketuarve, perceptimin e tyre mbi situatën dhe sugjerime për përmirësim të mbështetjes.

Pyetësi i plotë gjendet në Shtojcën 1. Në Shtojcën 2 gjeni bashkëlidhur listën e rekomandimeve nga të rinjtë në përgjigje të pyetjes *‘Çfarë sugjerimesh do t’i adresonit Bashkisë suaj për të përmirësuar mbështetjen e sektorit të rinisë?’*. Si më poshtë paraqitet analiza e të dhënave të gjeneruara shoqëruar me grafikët përkatës.

Të dhëna demografike/statistikore:


Kjo analizë u mbështet në një kampionim rastësor prej **191 personash**. Vihet re një reagim i ndryshëm përse i përket plotësimit të pyetësorit bazuar në gjininë e të anketuarve. **Shumica e të anketuarve janë identifikuar se i përkasin gjinisë femër në 58.6%**, ndërsa 36.1% meshkuj. Ndërkohë 5.2% kanë preferuar të mos përgjigjen.

1.1 Gjinia juaj
191 responses



Përse i përkët moshës, 85.9 % e anketuesve janë të rinj 15-18 vjeç dhe 3.1 % i përkasin moshës 19-24 vjeç. **Në total rreth 90 % e të anketuarve i përkasin grupmoshës 15 deri në 30 vjeç**. Pyetësi është plotësuar edhe nga të rinj nën moshën 15 vjeç, në masën 7.5%.


1.2 Mosha juaj
191 responses



109 të anketuar 57.1 % e tyre kanë vendbanim në Bashkinë Kuçovë dhe 81 të anketuar, 42.4 % e tyre në Bashkinë Skrapar dhe 1 anketues ka deklaruar vendbanim në Tiranë. Kjo shpërndarje është logjike nëse i referohemi numrit total të popullsisë në të dy Bashkitë ku Bashkia Kuçovë ka popullsi më të lartë se ajo e Skraparit.

1.4 Bashkia në të cilën ndodhet vendbanimi juaj:


191 responses



Nga 191 përgjigje, **33.5% kanë deklaruar se vendbanimi aktual ndodhet në zonë rurale** dhe **66.5% ndodhet në zonë urbane**. Kjo e dhënë është e rëndësishme pasi pasqyron zërin edhe të të rinjve të cilët kanë më pak akses në shërbime në tërësi dhe ato rinore në zonat rurale.

1.5 Vendbanimi juaj aktual ndodhet në:

191 responses




Perceptimi i situatës aktuale nga të rinjtë

Sipas rezultateve të këtij pyetësi, katër (nga 15+) çështjet kryesore që konsiderohen si probleme kyç me të cilat po përballen rinia në Bashkitë respektive janë zgjedhur:

1. Papunësia rinore (51.8%)
2. Situata ekonomike (49.2 %)
3. Ikja e trurit (34%%).
4. Mungesa e infrastrukturës/hapësirave rinore (28.8%)

2.1 Zgjidhni tre (3) çështje kryesore që ju i konsideroni si probleme kyç me të cilat po përballet rinia në Bashkinë tuaj


191 responses



Ekzistojnë nivele të ndryshme të pjesëmarrjes, duke filluar nga ai me pjesëmarrje më të ulët deri te niveli me pjesëmarrje më të lartë: informimi, konsultimi, angazhimi, bashkëpunimi dhe fuqizimi. Të anketuarit u pyetën nëse ishin të familiarizuar me të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimarrje. Bazuar në rezultatet e pyetësorit, vihet re se 52.8 % e të anketuarëve deklarojnë se janë disi **të familiarizuar me të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimarrje ose kanë nevojë për më tepër informacion**. 15.7 % e të anketuarve shprehën se i përdorin këto të drejta për pjesëmarrje, ndërsa 11.5% nuk i përdor pavarësisht se janë të familiarizuar me to, 14.7% nuk janë të familiarizuar me to.

2.3 A jeni i familjarizuar me të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimarrje?


191 responses



Në analizën e e përgjithshme të të dhënave të pyetjes nëse bashkia i ka angazhuar mjaftueshëm në proceset vendimmarrëse, **53.9% e të anketuarve shprehen as po as jo, 36.6% shprehen jo dhe vetëm 9.4% përgjigjen pozitivisht.**

2.4 A mendoni së Bashkia ju angazhon mjaftueshëm në procese vendimmarrëse?

191 responses



Të dhënat e **agreguara sipas bashkive** rezultojnë se në Bashkinë Kuçovë, 56.8 % e të anketuarve janë përgjigjur as po as jo, 33% janë përgjigjur JO, pra nuk janë dakord me dhe 10 % janë shprehur se janë pozitivisht. Ndërsa në Bashkinë Skrapar 50% e të anketuarve janë përgjigjur as po as jo, 41% janë përgjigjur JO dhe rreth 9% janë përgjigjur pozitivisht.

Në sesionin 2.2 të pyetësorit është kërkuar për të anketuarit të jepet opinionin ndaj katër pohimeve të ndryshme duke përdorur shkallën e vlerësimit nga 1 që tregonte aspak dakord deri në 5 që tregonte plotësisht dakord. Si më poshtë gjenden rezultatet e agreguara për çdo bashki:

Shkalla	1		2		3		4	
	Mendoj së në vendbanimin tim ka mjaftueshëm infrastrukturë/hapësi rë rekreative për tu përdorur nga të rinjtë		Mendoj se në vendbanimin tim zhvillohen mjaftueshëm nisma konkrete të aktivizimit rinor		Mendoj se në vendbanimin tim ofrohen shërbime cilësore për rininë nga pushteti lokal		Mendoj se më ofrohen mundësi për tu përfshirë në procese të vendimmarrjes lokale	
	Kuçovë	Skrapar	Kuçovë	Skrapar	Kuçovë	Skrapar	Kuçovë	Skrapar
1 (aspak dakord)	31%	37%	19%	36%	24%	33%	14%	35%
2	22%	22%	28%	22%	19%	35%	27%	28%
3	23%	9%	22%	12%	19%	17%	25%	12%
4	17%	23%	19%	22%	25%	11%	24%	19%
5 (plotësisht dakord)	4%	6%	10%	2%	9%	2%	6%	2%
Nuk jap dot qendrim	4%	2%	2%	5%	4%	1%	5%	4%

GJETJE DHE KONSTATIME MBI MBËSHTETJEN E SEKTORIT TË RINISË NË BASHKINË KUÇOVË DHE BASHKINË SKRAPAR: QASJE KRAHASUESE

Në Ligjin Nr. 75/2019 'Për Rininë', konkretisht tek neni 7 "Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore"; dhe neni 10 "Këshilli Vendor i Rinisë" parashikohen masat të cilat duhet të mërren nga NJVV-të për politikën rinore që synojnë krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin personal të të rinjve dhe për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike, sociale, ekonomike dhe kulturore, në nivel vendor dhe kombëtar, nëpërmjet veprimtarive që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve në vend.

Neni 7, pika 1/ë e këtij ligji kërkon po ashtu parashikimin në buxhetet e NJVV-ve të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore. Po ashtu neni 7, pika 1/dh, parashikon financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta.

Si më poshtë paraqiten disa gjetje lidhur me mbështetjen e sektorit të rinisë nga të dyja bashkitë në zbatim edhe të detyrimeve ligjore.

Numri i popullsisë sipas regjistrit civil	Bashkia Kuçovë: 55.293 banorë	Bashkia Skrapar: 16,581 banorë
Buxheti Total 2022 (plan)	521, 084, 717 (RMB 2022/PBA 22-24)	331,022,000 (PBA 22-24)
Transparenca	- Të dyja bashkitë kanë ngritur në faqet e tyre elektornike zyrtare hapësirën për programin e transparencës në të cilën publikohen dokumenta zyrtarë sipas kuadrit ligjor. Vlen të theksohet se në të dyja bashkitë shihet përmirësim në metodologjinë e raportimit duke filluar nga viti 2020. Gjithsesi ka hapësirë për përmirësim. Në Bashkinë e Kuçovës mungojnë të publikuara raportet dhe PBA përpara vitit 2020 si dhe mungon PBA 2023-2025. Ndërsa në Bashkinë e Skraparit janë të publikuara RMB-të e 2019 por pa përfshirë në to analizën narrative sipas metodologjisë së ndjekur në vijim, duke mos identifikuar indikatorët, produktet apo aktivitetet e pritshme për tu realizuar në kuadër të shpenzimeve për program buxhetor.	
Infrastrukturë e dedikuar për të rinjtë	- Infrastrukturë e dedikuar rinore ka në vartësi vetëm Bashkia Kuçovë si pjesë e institucionit Qendra Kulturore "Feniks". Kjo qendër ka Bord Drejtues i cili përzgjidhet nga vetë të rinjtë të cilët frekuentojnë Qendrën. Bordi ka në strukturë presidentin, zv presidentin, sekretarin dhe anëtarët, gjithsej 11 persona.	
Informacion mbi masat të mara në mbështetje të sektorit të rinisë.	- Informacion zyrtar mbi aktivitete rinore të realizuara mund të gjendet në raportet e Monitorimit të Buxhetit. Në rastin e Bashkisë Skrapar, pasqyrohet listë e aktiviteteve të zhvilluara në Qendrën Rinore në kuadër të realizimit të programit buxhetor mbi trashëgiminë kulturore, eventeve artistike dhe kulturore. Në rastin e Bashkisë Skrapar analiza është e cunguar në raportet e Monitorimit të Buxhetit në mungesë dhe të njëjve shpenzuese për infrastrukturë rinore si qendra rinore në rastin e Bashkisë Kuçovë.	
Përfshirja e rinisë në objektivat strategjike të planifikimit buxhetor	- Në të dyja bashkitë nuk ka adresim të dedikuar për të rinjtë në objektivat strategjike afatgjatë të PBA-ve respektive.	

Përfshirja në Buxhet program buxhetor i posaçëm për të rinjtë	- Tek të dyja bashkitë mungojnë në buxhetet e tyre fonde për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore. - Në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2020-2022 dhe atë 2023-2025 në asnjërën nga bashkitë nuk ka të përfshirë programe buxhetore të dedikuara politikave, masave për të rinjtë. Bashkia Kuçovë nuk është shprehur lidhur me pyetjen që adresonte këtë çështje në kërkesën zyrtare për informacion. - Ndërkohë Bashkia Skrapar ka shprehur vullnetin që në Buxhetin e vitit 2023 të parashikohej zë buxhetor i veçantë për veprimtaritë, projektet apo programet rinore. Gjithsesi në PBA-në 2023-2025 nuk identifikohet program buxhetor i dedikuar për politika, masa, nisma në mbështetje të të rinjve apo zë buxhetor i veçantë për këto veprimtari. Përkundrazi, në PBA-në 23-25 të Bashkisë Skrapar e 23-25 indikator i aktivitetit 'Aktivitete për edukimin e brezit të ri' në programin 'Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore' (08220) përshtet me tendencë ulëse.
Programe buxhetore të cilët kanë përfitues të rinj	- Në të dyja bashkitë janë të njëjta programet buxhetore të cilat ofrojnë mundësi për mbështetje të të rinjve si pjesë e popullatës së përgjithshme. Disa prej tyre: Programi 'Sport dhe Argëtim' (08130) Programi 'Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore' (08220). Programi 'Arsimi i mesëm i përgjithshëm' (09230) ku mbështeten dhe investimet më të mëdha kapitale në infrastrukturën shkollore. Programi 'Kujdesi social për familjet dhe fëmijet' (10430) - Gjithsesi, dy programet e para janë marrë më konkretisht në analizë. Kufizimi kryesor i hasur për një analizë buxhetore më të detajuar, është mungesa tek të dhënat e raportuara në të dyja bashkitë pasqyrimi jo i qartë i aktiviteteve si zëra buxhetorë që mbulohen në këto programe. Krahasimi i programeve për dy bashkitë vështirësohet nga fakti se RMB-të nuk kanë të njëjtën metodologji raportimi dhe fokusi ndryshon për elementë të caktuar buxhetorë.
Programi Buxhetor 'Sport dhe Argëtim'	- Në RMB-të e shqyrtuara për Bashkinë Kuçovë është raportuar si masë kryesore e ndërmarrë 'dizifektimi dhe mirëmbajtja e stadiumit për sektorin e sportit'. Nuk ka të dhëna për zëra buxhetorë në mbështetje specifike për grupmoshën e të rinjve. Në Bashkinë Skrapar është shtuar Në PBA 23-25 shtohet në përshkrimin e Programit Buxhetor 08130, Sporti dhe argëtimi në përshkrimin e programit edhe '...grante hua ose financime për të mbështetur ekipe apo lojtarë individualë'. Ky aktivitet nuk ka qenë planifikuar në PBA 22-24. Ndërkohë prej vitit 2020 është shtuar edhe indikator 'Numri i sportistëve të mbështetur'. Planifikohet të mbështeten 20 sportistë çdo vit për periudhën 2022-2023 duke treguar një qasje me të hapur ndaj mundësisë së mbështetjes direkte të të rinjve sportistë. Në mungesë të RMB-së janar-gusht 2022 nuk u evidentua ecuria për vitin 2022 lidhur me këtë indikator.
Programi 'Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore'	- Bazuar në RMB-të e të dyja bashkive konstatohet se sektori i rinisë krahasimisht është më i mbështetur nga Bashkia Kuçovë, duke u mbështetur nga ekzistenca e infrastrukturës rinorë të dedikuar: qendra rinore. Tek kjo bashki parashikohet produkt buxhetor që adreson 'Trajnime të të rinjve'.
Këshill Vendor Rinor i ngritur	- Të dyja bashkitë kanë ngritur KVR-të. Bashkia Kuçovë me Vendim nr. 10, datë 16.0.2022 (4 anëtarë). Bashkia Skrapar me VKB Nr.57, datë 29.09.2022 konfirmuar nga Prefektura me nr. 755/1, datë 11.10.2022.

Dokument strategjik për sektorin e rinisë.	- Asnjë nga bashkitë nuk ka dokument strategjik për sektorin e rinisë të hartuar. Bashkia Kuçovë shprehet në përgjigje zyrtare se : 'Hartimi i një plani strategjik për rininë është një ndër prioritetet për vitin 2022'. Ndërkohë Bashkia Skrapar përgjigjet se 'Akoma nuk është hartuar një dokument strategjik për sektorin e rinisë, por parashikohet të realizojmë një plan të tillë në vijim.
Përmbledhje mbi realizimin e disa nga detyrimet kryesore të kuadrit ligjor për rininë.	- Të dyja bashkitë shënojnë progres për sa i përket ngritjes së KVR-së zyrtarisht. Por, është për tu vlerësuar angazhimi kuptimplotë i këtyre strukturave në mbështetje të sektorit të rinisë në vijim. - Kanë të të ngritur strukturën administrative e cila mbulon de juro çështjet rinore. - Bashkia Kuçovë përmbush detyrimin e sigurimit të infrastrukturës rinore me funksionimin e Qendrës rinore si hapësirë e dedikuar për aktivitetet rinore. Bashkia Skrapar nuk ka infrastrukturë rinore të dedikuar. - Tek të dyja bashkitë mungon dokumenti strategjik apo plani i veprimit në të cilën të jenë të jenë përcaktuar objektivat vendore dhe prioritetet për respektimin e të drejtave të të rinjve, mbrojtjen dhe fuqizimin e të rinjve. - Tek të dyja bashkitë mungojnë në buxhetet e tyre fonde për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore.

REKOMANDIME

Hartimi dhe zbatimi i politikave vendore për të rinjtë në sektorë të ndryshëm ekonomikë.

- Të hartohen dokumenta strategjikë/plane veprimi strategjike në secilën bashki ku të planifikohet hartimi dhe zbatimi i politikave vendore në fushën e rinisë, të cilat të synojnë *‘krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin personal të të rinjve dhe për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike, sociale, ekonomike dhe kulturore, në nivel vendor dhe kombëtar, nëpërmjet veprimtarive që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve në vend.’*²⁶ Deri në hartimin e këtyre dokumentave, rekomandohet të konsiderohet si dokument referencë për politikën, Strategjia Kombëtare për Rininë dhe Plani i Veprimit 2022-2030²⁷.
- Të zbatohen masa lehtësuese/mbështetëse për të rinjtë sipërmarrës siç janë lehtësirat fiskale. *(Ndërhyrja mund përfshihet në programin buxhetor ‘Mbështetje për zhvillimin ekonomik’ (04130).*
- Të ofrohet mbështetje me grante të vogla për ide biznesi inovative nga të rinjtë duke u përfshirë në buxhetet e bashkive.
- Të ofrohen lehtësira/mbështetje për të rinjtë të cilët investohen në sektorin e bujqësisë/blektorisë. Të rinjtë e zonave rurale të informohen mbi mundësitë për përfitim nga burime financiare të ndryshme. Këto mund të jenë si fonde publike edhe ato të ndihmës së huaj si përshembull mbështetja e fondeve IPARD, për të mbështetur iniciativë në këtë sektor të ndërmarra nga të rinjtë. Në këtë drejtim, bashkëpunimi me AZHBR-në, si institucioni i akredituar për administrimin e fondeve nga BE, fokusuar në zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme dhe diversifikimin e ekonomisë rurale, do të ishte me vlerë për sa i përket informimit dhe mbështetjes së të rinjve mbi mundësitë dhe procedurat e aplikimit.²⁸

Përfshirja e të rinjve në proceset vendimmarrëse

- Të përfshihen Këshillat Vendorë Rinorë të ngritur gjatë vitit 2022 në procese konsultuese dhe vendimmarrëse nga Bashkia. Ngritja e këtyre strukturave duhet të vijohet me angazhim përmbajtësor për sa i përket qëllimit për të këshilluar njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë; të vlerësojë situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor; të propozojë përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë, sipas parashikimit në kuadrin ligjor.

Planifikimi Buxhetor Afatmesëm dhe të rinjtë

- Të përfshihen në qëllimet apo/ose objektivat e Planit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe mëtej të mbështetjes së sektorit të rinisë. Një model referencë mund të jetë ai i PBA-së 2022-2024 e Bashkisë së Tiranës. Kjo bashki përfshin në qëllimet kryesore të programit të PBA22-24 sektorin e rinisë titulluar *‘Investim afatgjatë për Rininë - Tirana si Kryeqyteti Europian i Rinisë’*.²⁹
- Të përfshihen indikatorë performance në nivel qëllimi/objektivi por dhe programesh të të cilët të cilët targetojnë të rinjtë.
- Të përfshihen produkte konkrete në mbështetje të të rinjve, në programet buxhetore.

²⁶ Sipas përcaktimit në Ligjin nr. 75/2019 “Për rininë”, neni 3/e.

²⁷ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 26.10.2022

²⁸ Për më shumë informacion, konsultohet faqja zyrtare e AZHBR-së: <http://ëëë.azhbr.gov.al/programi-ipard/>

²⁹ Bashkia Tiranë, PBA 22-24, faqe 22, https://tirana.al/uploads/2022/1/20220110143302_programi-buxhetor-afatmesem-2022-2024.pdf

- Të planifikohen fonde për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e programeve, projekteve dhe veprimtarive rinore *'për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve.'*
- Në Bashkinë e Kuçovës të akordohet zë buxhetor i dedikuar për zhvillimin e aktiviteteve rinore në qendrën rinore përveç mirëmbajtjes dhe burimeve njerëzore. Bashkia e Skraparit në mungesë të një hapësirë rinore të dedikuar, mund të përdorë hapësira të tjera publike për të zhvilluar aktivitete rinore duke akorduar zë buxhetor të posacëm për to.

Struktura administrative të dedikuara për rininë tek të dyja bashkitë

- Të ketë angazhim përmbajtësor të strukturave për të rinjtë pranë Bashkive në mbështetje të sektorit të rinisë. Të jenë në kërkim të vazhdueshëm për mundësi mbështetje të sektorit nga programe kombëtare dhe ndërkombëtare. Përshembull aplikimi në thirrje të institucioneve publike si ato nga Agjencia Kombëtare e Rinisë ³⁰ Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ³¹, e të tjera.
- Të bashkëpunojë me organizatat për të rinjtë, organizata rinore dhe organizma të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të ritur mbështetjen për sektorin e rinisë në bashkitë respektive.

Sigurimi i Transparenës publike

- Të hartohen raportet e monitorimit të buxhetit me analizë të qartë dhe të kuptueshme për publikun lidhur aktivitetet specifike/zërat buxhetorë të financuar. Në këtë mënyrë këto analiza mund të jenë të lexueshme lidhur me buxhetin e alokuar në mbështetje të të rinjve dhe sektorit të rinisë.
- Në përplotësim të rekomandimit të mësipërm, të publikohet së bashku me Planet Buxhetore Afatmesme edhe Pasqyra e Planifikimit të Buxhetit të Njërive Shpenzuese, e detajuar në nivel funksioni, programi buxhetor dhe artikulli, për të lehtësuar leximin e buxhetit dhe shpenzimeve nga publiku. Një model referues është Pasqyra e publikuar nga Bashkia e Tiranës shoqërues i PBA 22-24.³²

³⁰ Faqja zyrtare e AKR-së <http://rinia.gov.al/thirrja-e-dyte-projekt-propozime-rinore-njesite-e-veteqeverisjes-vendore/>

³¹ Faqja zyrtare e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, <https://siper marrja.gov.al/thirrja-e-pare-per-mbeshtetje/>

³² Bashkia Tiranë, Planifikimi i Buxhetit të Njërive Shpenzuese për vitin 2022, 56437ddb0955aa4a4748882214d7820ce62e72e26f680ce0a1a341709bc9f43a.xlsx (tirana.al)

Bibliografia

Bashkia Kuçovë, RMB 2021.
Bashkia Kuçovë, RMB 2020.
Bashkia Kuçovë, PBA 2022-2024.
Bashkia Skrapar, RMB 2021.
Bashkia Skrapar, PBA 2023-2025.
Bashkia Skrapar, PBA 2022-2024.
Bashkia Skrapar, RMB 2019.
Bashkia Skrapar, RMB 2021.
Bashkia Skrapar, RMB 2020.
Bashkia Skrapar, RMB 2019.
Bashkia Skrapar, Përgjigje kërkesës për informacion, datë 16 nëntor 2022.
Bashkia Skrapar, Vendim i Këshillit Bashkiak nr.57, datë 29.09.2022.
Bashkia Skrapar, Qendra Rekreative, faqja zyrtare.
Bashkia Tiranë, PBA 22-24.
Bashkia Tiranë, Planifikimi i Buxhetit të Njësive Shpenzuese për vitin 2022.
[56437ddb0955aa4a4748882214d7820ce62e72e26f680ce0a1a341709bc9f43a.xlsx \(tirana.al\)](#)
Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”
Qarku Berat, faqe zyrtare, parë per herë të fundit në datë 6.12.2022.
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 26.10.2022, ‘Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të veprimit 2022-2030’.

Aneksi 1- Pyetësor

Mbështetja e Sektorit të Rinisë nga Pushteti Lokal Dhjetor 2022

Pjesa 1: Informacion

Ky pyetësor synon të masë perceptimin e të rinjve në Bashkitë Kuçovë dhe Skrapar mbi zbatimin e politikave rinore në bashkitë e tyre, ekzistencën e infrastrukturës për rininë, dhe ekzistencën e nismave konkrete të aktivizimit rinor, si dhe cilësinë e shërbimeve që ofrohen për ta.

Informacion:

- Pyetësi është anonim dhe shpreh qëndrim personal.
- Opinioni juaj do të përdoret për të përmirësuar planifikimin e aktiviteteve rinore në Bashkitë Kuçovë dhe Skrapar.

Seksioni 1: Të dhëna demografike/statistikore

Qarkoni përgjigjen që përshkruan më mirë situatën tuaj:

1.1 Gjinia Juaj:

- ☐ Femër
- ☐ Mashkull
- ☐ Preferoj të mos përgjigjem

1.2 Mosha juaj:

- ☐ Nën 15 vjeç
- ☐ 15-18 vjeç
- ☐ 19-24 vjeç
- ☐ 25-30 vjeç
- ☐ 31-40 vjeç
- ☐ 41-50 vjeç
- ☐ Mbi 50 vjeç

1.3 Niveli i arsimit që keni përfunduar:

- ☐ Arsimi bazë
- ☐ Shkolla e Mesme e Lartë (gjimnaz, shkollë artistike, shkollë profesionale)
- ☐ Programet e studimit me karakter profesional
- ☐ Cikli i parë i studimeve (Bachelor)
- ☐ Cikli i dytë i studimeve (Master: i Shkencave, i Arteve, Profesional)
- ☐ Cikli i tretë i studimeve (Doktoraturë, Specializim, Master ekzekutiv)
- ☐ Tjetër:

1.4 Bashkia në të cilën ndodhet vendbanimi juaj:

- ☐ Bashkia Skrapar
- ☐ Bashkia Kuçovë
- ☐ Tjetër

1.5 Vendbanimi juaj aktual ndodhet në:

- ☐ Zonë urbane
- ☐ Zonë rurale

Seksioni 2: Perceptimi i situatës aktuale

2.1 Zgjidhni tre (3) çeshtje kryesore që ju i konsideroni si probleme kyç me të cilat po përballet rinia në Bashkinë tuaj:

- ☐ *Papunësia rinore*
- ☐ *Situata ekonomike*
- ☐ *Ikja e trurit/emigrimi i të rinjve*
- ☐ *Krimi*
- ☐ *Mungesa e infrastrukturës/ hapësirave rinore*
- ☐ *Korrupsioni*
- ☐ *Pabarazia gjinore*
- ☐ *Probleme mjedisore (përfshirë dhe efektet e ndryshimeve klimatike)*
- ☐ *Probleme me sistemin e drejtësisë*
- ☐ *Probleme me mbrojtjen e të drejtave të njeriut*
- ☐ *Mungesë mbështetje të personave me aftësi të kufizuara*
- ☐ *Mungesë e politikave rinore nga pushteti lokal*
- ☐ *Mungesë të aktiviteteve që mbështesin potencialin rinor*
- ☐ *Mungesa e mundësive për të përfshirë të rinjtë në vendimmarrje.*
- ☐ *Mungesë arsimit cilësor*
- ☐ *tjetër...*

2.2 Ju lutemi jepni opinionin tuaj ndaj pohimeve të mëposhtme duke qarkuar një nga shkallët e vlerësimit (1 deri në 5)

2.2.1 Mendoj se në vendbanimin tim ka mjaftueshëm infrastrukturë/hapësirë rekreative për tu përdorur nga të rinjtë.

- ☐ *nuk jam aspak dakord*
- ☐ *nuk jam dakord*
- ☐ *as nuk jam dakord, as jam dakord*
- ☐ *jam deri diku dakord*
- ☐ *jam plotësisht dakord*
- ☐ *nuk jap dot qëndrim*

2.2.2 Mendoj se në vendbanimin tim zhvillohen mjaftueshëm nisma konkrete të aktivizimit rinor.

- ☐ *nuk jam aspak dakord*
- ☐ *nuk jam dakord*
- ☐ *nuk jam dakord, as jam dakord*
- ☐ *jam deri diku dakord*
- ☐ *jam plotësisht dakord*
- ☐ *nuk jap dot qëndrim*

2.2.3 Mendoj se në vendbanimin tim ofrohen shërbime cilësore për rininë nga pushteti lokal.

- ☐ *nuk jam aspak dakord*
- ☐ *nuk jam dakord*
- ☐ *as nuk jam dakord, as jam dakord*
- ☐ *jam deri diku dakord*
- ☐ *jam plotësisht dakord*
- ☐ *nuk jap dot qëndrim*

2.2.4 Unë mendoj se më ofrohen mundësi për tu përfshirë në procese të vendimmarrjes lokale.

- ☐ nuk jam aspak dakord
- ☐ nuk jam dakord
- ☐ as nuk jam dakord, as jam dakord
- ☐ am deri diku dakord
- ☐ jam plotësisht dakord
- ☐ nuk jap dot qëndrim

2.3 A jeni i familjarizuar me të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimmarrje?

(Përshembull të drejtën për informim në institucionet publike, konsultim të politikave dhe projektakteve dhe bashkëqeverisje për politika rinore dhe platformat e tyre, angazhuar në proceset konsultuese të projekt buxhetit në nivel qendror ose nga bashkia)

- ☐ Po, dhe i përdor këto të drejta/instrumenta
- ☐ Po, por nuk i kam përdorur këto të drejta/instrumenta
- ☐ Disi
- ☐ Kam dëgjuar por kam nevojë për më tepër informacion
- ☐ Jo
- ☐ Tjetër

2.4 A mendoni se Bashkia ju angazhon mjaftueshëm në procese vendimmarrëse?

- ☐ Jo
- ☐ As po as Jo
- ☐ Po

2.5 Çfarë sugjerimesh do t'i adresonit Bashkisë suaj për të përmirësuar mbështetjen e sektorit të rinisë?

Faleminderit !

Aneksi 2- Rekomandime nga anketuesit për bashkitë respektive

BASHKIA KUÇOVË
Çfarë sugjerimesh do t'i adresonit Bashkisë suaj për të përmirësuar mbështetjen e sektorit të rinisë?
Të buxhetoje fonde për qëndren rinore dhe të rinjte.
Te qëndrojnë të rinjtë në qytet. Mos të ikin jashtë shtetit. Dhe të ketë me shumë fonde nga qeveria.
Hapjen e vendeve të punës për të rinjtë.
Ti ofrojnë të rinjve një buxhet.
Mund të kushtojnë me shumë rëndësi aktiviteteve për të rinj duke tërhequr kështu vëmendjen e tyre.
Arsimi dhe punësimi
Te ketë një buxhet për rinin nëpërmjet qëndres rinore.
Krijimi i fondit të pavarur të të rinjve.
Me shumë aktivitete.
Te ketë vende pune që mos largohen të rinjtë. Te ketë drejtesi.
Përmirësim i infrastruktures.
Me shumë aktivitete sociale, sportive etj.
Te ketë me shumë vende pune për të rinjtë.
Te ketë me shumë vende pune për të rinjtë që vendi ynë të jetë më i gjallëruar.
Te ketë vende pune për të rinjtë që të kenë një të ardhme.
Për të krijuar me shumë hapësira për të rinjtë. Te ofrohet punësimi edhe pse jemi një vend i vogël.
Te ketë me shumë vende pune për të rinjtë.
Infrastruktura më të mirë. Me shumë fonde.
Te ketë fonde për të rinjtë të cilët nuk kanë mundësi financiare.

BASHKIA SKRAPAR
Çfarë sugjerimesh do t'i adresonit Bashkisë suaj për të përmirësuar mbështetjen e sektorit të rinisë?
Nje qender rinore.
Duhet te degjojne te rinjte me shume dhe te munden te organizojne me shume aktivitete
Meruni me rinine jo me politiken se na fundoset me angazhim e rinise ne politike.
Te degjohet me shume zeri yne dhe te meren parasysh mendimet tona
Te krijohen qendra sportive.

Te rrisi rrogat
Asnje
Qender rinore per aktivitete te ndryshme.
Hapesira te mjaftueshme per te rinj - Aktivitete.
Hapja e me shume mjediseve qe promovojne angazhimin e te rinjve ne me shume aktivitete.
Hapja e me shume mjediseve qe promovojne angazhimin e te rinjve ne me shume aktivitete.
Te zhvillohen me shume aktivitete ndaj te rinjve.
Krijimi i vendeve te punes. Qendrave te aktiviteteve.
Te zhvillohen me shume aktivitete ndaj te rinjve.
Hapja e me shume mjediseve qe promovojne angazhimin e te rinjve ne aktivitete.
Hapja e me shume mjediseve qe promovojne angazhimin e te rinjve ne aktivitete si per ti familjarizuar ata me aktivitete mbi shkollen por edhe jasht shkollore per te kaluar nje paradite me shoqerine. Shembull Konkret Fushat e basketbollit / volejbollit e gjimnazit nuk lejohen te hapet per te luajtur rinia, por burrat e qytetit.
Qe kur te beje aktivitete te na marri.
Zhvillimi i sa me shume aktiviteteve per mbeshtetjen ndaj rinise. Te shtojme politikat rinore.
Zhvillime sa me shume rinore.
Te ulen taksat, Nafta se na ropen, Vetem lek po japim ushkorritem. U ngeli goja lek lek.
Te shtojme poilitikat rinore.
Te shtojme politikat rinore dhe te rrisim informimin per ta.
Zhvillimi dhe organizimi i rinise ne aktivitete. Te shtojme politikat rinore.
Nuk kam kualifikimin e duhur per tiu pergjigjur kesaj pyetje.
Te kete vende me te mira dhe me efektive ne lidhje me femijet.
Per njoftimin e njerezve per te drejtat e tyre dhe te marrin letrat informuese qe vin per ta dhe mos mbahen nga personat e bashkis dhe te informohen pas nje kohe shume te vonekur ajo leter nuk ka me vler por te kryen veprimet.
Me shume aktivitete.
Me shume aktivitete dhe mendime ne vendimarrje te bashkise madje dhe ne ligje.
Me shume pune.
Te na mundesoje vende pune se ika ne angli.